



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit: 23.10.1-2009-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
TË PASQYRAVE FINANCIARE TË KOMPANISË RAJONALE TË
MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A PRISHTINË PËR FUND VITIN 31
DHJETOR 2009**

Prishtinë, Korrik 2010

Tabela e përmbajtjes

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit
- IV. Qasja e auditimit
- V. Opinioni i auditimit
- VI. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e KRM''Pastrimi''Sh.A- Prishtinë dhe vlerësimet e ZAP-it

Lista e shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjensioni për Prokurim Publik
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Banka Ekonomike
BpB	Banka private e Biznesit
BKP	Banka Kreditore e Prishtinës
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
LMFPP	Ligji Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Për Prokurimin Publik në Kosovë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NLB	Nova Lubljanska Banka
NP	Ndërmarrja Publike
OE	Operatori Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
SHA	Shoqëri Aksionare
SKK	Standardet Kosovare të Kontabilitetit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzimi Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm “Kompania”) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi ynë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne kemi konsideruar se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të KRM “Pastrimi” me 31 Dhjetor 2009 dhe rezultatet financiare gjatë vitit në fjalë. Si theksim i çështjes ne dëshirojmë t’ju tërheqim vëmendjen sa i përket paraqitjes së të arkëtueshmeve dhe vlerësimit të provizioneve për borxhet e këqija. **(ISSAI 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).**

Kompania nuk ka pasur një politikë adekuate të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Ajo ka provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta të gjitha të hyrat e painkasuara. Kjo paraqitje nuk ishte bërë në pajtim të plotë me standardet e kontabilitetit dhe ligjet e aplikueshme vendore.

Më tutje auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i kompanisë.

Dobësitë kryesore të menaxhimit janë si në vijim:

1. Në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë të gjitha shënimet shpjeguese dhe shpalosjet e kërkuara me SKK-ve, lidhur me të hyrat, metodat e zhvlerësimit të pasurive fikse dhe vlerësimit të stokeve;
2. Kompania nuk i kishte regjistruar shpenzimet në kodet e duhura, por i kishte regjistruar të gjitha në një kod të vetëm;
3. Koston e shërbimeve të kryera, kompania e kishte trajtuar si shpenzime të aktiviteteve operative, që nuk është në pajtim me SKK-të;
4. Nuk janë efektive mekanizmat për inkasimin e borxheve. Shkalla e ulët e inkasimit vë në pikëpyetje vazhdimësinë e kompanisë;
5. Sipas Nenit Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, secila NP lokale duhet ta këtë të themeluar Bordin e Drejtorëve. Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se në këtë kompani ende nuk është themeluar ky Bord;

6. Kompania ende nuk ka arritur ta themeloj Njësinë për Auditimin e Brendshëm. Funkzioni i kësaj njesie do të ndihmonte funksionimin e kontrollit të brendshëm duke sugjeruar përmirësime të sistemit të kontrollit; dhe
7. Pajisjet e kompanisë nuk janë të regjistruara dhe identifikuar sipas bar kodeve.

Kjo dhe dobësitë e tjera të identifikuar në këtë raport na kanë shtyre deri të një konkluzion i përgjithshëm se nevojitet përpjekje e mëtutjeshme nga menaxhmenti për të siguruar një menaxhim me të mirë dhe me kualitativ të kompanisë.

Ne rekomandojmë aksionaret e kompanise që të themelojnë Bordin e Drejtorëve, i cili do të sigurojë një ambient të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit financiar të organizatës.

Menaxhmentit të kompanisë i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Në këtë raport janë bërë më pas një numër ndryshimesh.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat në si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në shtojcën 2 të këtij raporti.

Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë së Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Publike të Kosovës.

Është përgjegjësi e kompanisë të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje të plotë me të gjitha kushtet për raportim financiar dhe parimet e kontabilitetit aktual për shoqëritë aksionare të përcaktuara në ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.

III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" ka të bëjë me pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM *Rr. Gazmend Zajmi nr. 59,10000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381(0) 38 2535 217 - FAX: +381(0) 38 2535 219

- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

IV. Qasja e auditimit

Qasja jonë e auditimit është zhvilluar gjatë këtij viti. Kemi adoptuar manualin e ri për auditimin tonë të rregullsisë që është konform standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht. Ne kemi analizuar qasjen tonë të auditimit sipas katër fushave kryesore, si vijon:

- Të kuptuarit e Entitetit – të kuptojmë plotësisht entitetin, përfshirë këtu edhe kornizën e autoriteteve dhe të sistemeve kyçe, në mënyrë që të kuptojmë çështjet kyçe të cilat mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare;
- Identifikimi i Rrezikut: duke kuptuar Entitetin dhe nga rezultatet e mëhershme të auditimit, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në pasqyra financiare ose mospërputhshmëri me ligjin;
- Kontrollat e Brendshme të Menaxhimit: aty ku identifikohen rreziqet, në kërkojmë të identifikojmë menaxhimin dhe kontrollat monitoruese të cilat mund të zvogëlojnë ato rreziqe, dhe
- Përdorimi i Procedurave Substanciale dhe Analitike – për të ofruar një siguri të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrolle janë identifikuar.

Ne duhet kuptuar kontrollat e brendshme mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e keq deklarimit material. Në përputhje me këtë kërkesë dhe punës sonë sipas kontrolleve të brendshme të menaxhimit të theksuara më lartë, në dokumentojmë kontrollat e menaxhimit dhe ato monitoruese që të na ndihmojnë në informimin e gjykitimit tonë për rreziqet e keq deklarimit material.

Ne planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit. Në terme të përgjithshme, (siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalosja, keq deklarimi, përfshirja ose lënja jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga pasqyrat financiare tek shfrytëzuesit.

Sipas qasjes sonë të rishikuar të auditimit, ne ndërmorëm një auditim të parakohshëm përgjatë këtij viti. Auditimi i parakohshëm duhet të kuptohet si një auditim që fillon nga viti fiskal që është nën auditim me qëllim të dhënies së rekomandimeve mbi atë se si:

- mund të trajtohen rekomandimet e mëparshme;
- të adresohen Pasqyrat Vjetore Financiare; dhe
- të adresohen çështjet e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM *Rr. Gazmend Zajmi nr. 59,10000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381(0) 38 2535 217 - FAX: +381(0) 38 2535 219

Këtë vit ne kemi raportuar konkluzionet dhe rekomandimet tona nga auditimet e parakohshme në Memorandumet e Auditimit, në Janar të vitit 2010.

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të kompanisë për vitin 2009;
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të kompanisë janë përgatitur në pajtim me kërkesat nga SNKK si dhe kornizës së SKK;
3. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të 1% si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

Në këtë raport kemi përmbledhë auditimin e këtij viti dhe kemi dhënë një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2009.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të Kompanisë, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

V. Opinioni i auditimit

Për mendimin tonë, *pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të KRM “Pastrimi” me 31 Dhjetor 2009 dhe rezultatet financiare gjatë vitit në fjalë. Si theksim i çështjes ne dëshirojmë t’ju tërheqim vëmendjen sa i përket paraqitjes së të arkëtueshmeve dhe vlerësimit të provizioneve për borxhet e këqija. **(ISSAI 400: Opinioni i pakualifikuar me theksim të çështjes).**

Kompanisë i ka munguar një politikë e mirë e njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Ajo ka provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta të gjitha të hyrat e painkasuara. Kjo paraqitje nuk ishte bërë në pajtim të plotë me standardet e kontabilitetit dhe ligjet e aplikueshme vendore.

VI . Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Pasqyrat financiare për vitin financiar 2008 nuk ishin audituar. Prandaj, ne jemi fokusuar vetëm në rekomandimet e dhëna gjatë auditimit tonë të përkohshëm për pasqyrat financiare të vitit 2009.

Fushat më të rëndësishme të cilat ende nuk kanë arritur të adresohen janë:

- a. Rekomandimi për zgjedhjen e Bordit të Drejtorëve;
- b. Rekomandimet për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm;
- c. Rekomandimet për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me ligjet e aplikueshme;
- d. Rekomandimet për paraqitjen e drejtë të provizioneve si dhe gjetjen e një mekanizmi për arkëtimin e borxheve të dyshimta; dhe
- e. Rekomandimet për regjistrimin e të gjitha pajisjeve me barkode.

Gjatë fazes së dytë të auditimit kemi vërejtur se kompania nuk ka arritur që të adresoj plotësisht rekomandimet tona të dhëna në memon e përkohshme të auditimit. Andaj i rekomandojmë kompanisë që të adreson të gjitha rekomandimet tona në mënyrë që të përmirësohet ambienti i kontrollit të brendshëm si dhe përmirësimi i raportimit financiar.

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

VII.1 Rezultati Financiar

Një analizë e rezultatit financiar për të hyrat dhe shpenzimet e vitit 2009

Tabela 1: Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

Zërat/Vitet	2009	2008	2007
Të hyrat e faturuara	4,010,772	3,609,032	3,944,731
Të hyrat e tjera	187,803	5,436	107,749
Totali	4,198,575	3,614,468	4,052,480
KMSH	-	-	-
Fitimi Bruto	4,198,575	3,614,468	4,052,480
Pagat Bruto	1,462,665	1,390,596	1,296,695
Mirëmbajtja dhe riparimet	163,457	146,863	151,908
Shpenzimet Administrative	40,042	62,294	114,939
Rryma Elektrike	5,195	10,696	9,909
Shpenzimet e Derivateve	444,491	433,676	398,842
Shpenzimet e Qirasë	5,000	6,650	8,250
Shlyerja e Borxheve të këqija	1,151,621	1,265,394	1,164,221
Shpenzimet tjera operative	698,068	530,994	788,684
Gjithsej shpenzimet operative:	3,970,539	3,847,162	3,933,448
Zhvlerësimi i Mjeteve të Punës	184,396	139,342	94,621
Zhvlerësimi i Ndërtesave	44,110	0	44,170
Gjithsej zhvlerësimi:	228,506	139,342	138,791
Neto Fitimi (Humbja)	(471)	(372,036)	(19,760)

Nga tabela me lartë mund të vërehet se kompania gjatë vitit 2009 ka arritur të realizoj të hyra 4,198,575€. Nëse i krahasojmë të hyrat sipas viteve shohim se gjate vitit 2009 te hyrat janë rritur për 584,107€, ose 16%. Ndërsa shpenzimet janë rritur vetëm për 212,541€, ose 5%. Si rezultat i kësaj gjatë vitit 2009 kompania ka një rezultat më të mirë financiar duke minimizuar humbjen në vetëm 471€.

Ne kemi testuar në detaje pasqyrat financiare dhe kemi ardhur në përfundim se ato përmbajnë në vete disa gabime të cilat do ti shpalosim në vijim:

- Parapagimet për sigurimin e automjeteve janë regjistruar si shpenzime të sigurimeve;
- Shpenzimet nga kontestet gjyqësore janë regjistruar si shpenzime të terminalit;
- Regjistrime të gabueshme të faturave për furnizime të pajisjeve duke përfshirë vlerën me TVSH-në; dhe
- Shpenzimet e kostos së shërbimeve (KMSH është regjistruar në kategoritë e shpenzimeve operative.

Tabela 2 Vështrim i Bilancit të Gjendjes

Zërat/Viti	2009	2008	2007
Mjetet Qarkulluese	2,483,318.76	1,833,585.26	1,600,700.78
Arka dhe Xhirrollogaria	323,881	338,887	418,969
Llogari të Arkëtueshme	12,309,874	1,443,891	1,130,821
Kërkesat tjera Afatshkurta	19,435	18,738	20,858
Shpenzimet e parapaguara dhe të hyrat Akruale	699	-	-
Stoqet	37,337	32,067	30,051
Provizionet	-10,207,908	-	-
Mjetet Fikse	6,525,347	6,470,780	6,054,668
Zhvlerësimi	-506,639	-278,132	-138,791
Impiantet, pajisjet, makinat	1,404,781	1,121,708	565,061
Ndërtesat	882,205	882,205	883,398
Toka	4,745,000	4,745,000	4,745,000
Gjithsej Asetet	9,008,666	8,304,365	7,655,369
Gjithsej detyrimet Afatshkurta	5,572,054	5,064,222	4,655,191
Llogarit e Pagueshme	1,243,835	1,052,299	688,165
Tatimi në të Ardhurën i Pagueshëm	1,685,160	1,476,339	1,338,581
Shpenzimet Akruale dhe Avancet e marrura	105,635	-468	92,393
Tatimi në fitimit i periudhës raportuese	2,536,052	2,536,052	2,536,052
Detyrimet tjera Afatshkurta	1,370	-	-
Kapitali	3,436,612	3,240,142.68	3,000,177
Rezervat Rivlerësuara	2,579,130	2,951,165	2,970,925
Dhuratat e Kapitalizuara	25,000	25,000	25,000
Fitimet e Bartura	-470	-372,035	-19,759
Ndihmat ,Grantet dhe dhuratat financiare	832,952	636,012	24,012
Gjithsej Detyrimet dhe Kapitali	9,008,666	8,304,365	7,655,369

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelën me larte vërejmë se kompania në vitin 2009 ka ndërruar politikat e prezantimit të pasqyrave financiare. Kjo vërehet sidomos të paraqitja e të arketueshmeve dhe provizioneve për borxhet e këqija. Në vitin 2008 kompania ka regjistruar llogarite e arketueshme neto duke i zbritur provizionet e borxheve të keqija, ndersa në vitin 2009 i ka prezantuar llogaritë e arketueshme bruto. Sa i përket provizionimeve të borxheve të këqija politikë e kompanisë ishte që të regjistroj si borxhe të dyshimta të gjitha të hyrat e pa arkëtueshme. Kjo politikë ka rezultuar që pasqyrat financiare të kompanisë të paraqiten me humbje.

Së këndejmi, problem serioz është shkalla e ulët e inkasimit të të hyrave. Ky problemi mund të ndikon edhe në likuiditetin e kompanisë duke mos arritur ti paguajë të gjitha obligimet në afatet e parapara.

Nga tabela po ashtu vërejmë se gjatë vitit 2009 obligimet janë rritur për 507,832€, ose 10%. Kjo vërehet sidomos të llogaritë e pagueshme, si dhe të tatimi i pagueshëm.

VII.2 Pasqyrat Financiare

VII. 2.1 Cilësia e informatave

Kompania është e obliguar që Raportimin Financiar dhe Pasqyrat Financiare të përgatiten në përputhje me SNK apo Standardet e pranuar vendore, në pajtim me ligjet aplikative në Kosovë dhe Udhëzimet e Thesarit.

Auditimi ynë ka shpalosur këto të gjetura:

- Sipas analizave dhe rishikimit të pasqyrave financiare kemi vërejtur se kompania aplikon provizione për borxhe të dyshimta. Ne nuk kemi gjetur se kompania ka politikë të shkruar për këto provizione;
- Sipas SKK shpenzimet e parapaguara shfaqen atëherë kur paguhet paraja para se të përdoret artikulli, shërbimi apo dobia, ndërsa shpenzimet përkatëse njihen gjatë periudhës përkatëse. Ne kemi vërejtur se kompania nuk ka zbatuar SKK, por këtë parapagim e ka regjistruar si shpenzim të plotë; dhe
- Kompania nuk kishte prezantuar dhe shpalosur politikat e kontabilitetit siç janë shpalosja për njohjen e të hyrave, llojet e amortizimit dhe metodën e zhvlerësimit.

VII. 2.2 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Kompania ka përgatitur katër pasqyrat financiare, mirëpo i mungonte elementi i pestë i pasqyrave financiare shënimet shpjeguese dhe shpalosjet përkatëse. Ne kemi vërtetuar se pasqyrat financiare nuk janë konsistente prej vitit në vit, dhe kompania nuk ka arritur ti shpalosë ndërrimet e politikave kontabël.

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit akrual të kontabilitetit, dhe janë nënshkruar më 31 mars 2010 nga më kohë Zyrtari kryesor administrativ dhe zyrtari kryesor financiar.

Për shkak të mungesës së Bordit të drejtorëve, Zyrtarët e kompanisë nuk kanë përgatitur raporte tre mujore në të cilat do të duhej të prezantohej përshkrimi i performancës afariste dhe financiare, ndryshimeve në strukturën organizative, etj.

Konkluzion

Ne konkludojmë se kompania i ka prezantuar katër pasqyrat financiare, mirëpo nuk ka arritur të përgatisë edhe pasqyrën e politikave dhe shpalosjeve që kërkohet më SKK-të, në të cilën do të shpaloseshin të gjitha politikat e kompanisë, si dhe një pjese e zërave që kërkojnë sqarime shtesë. Ne konkludojmë se kompania nuk ka arritur të siguroj një nivel të kënaqshëm të inkasimit të mjeteve e cila mund ta rrisë rrezikun për funksionimin normal të kompanisë.

Përpos kësaj kompania nuk ka bërë një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta që ka si pasojë rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që të siguroj:

- Pasqyrat Financiare të jenë të përgatitura në pajtim më SNK, SKK dhe ligjet e aplikueshme në vend, duke përfshirë pesë komponentet e saj. Në pasqyrat e shpalosjeve veçanërisht të rëndësishme janë politikat e zhvlerësimit, baza për përgatitjen e pasqyrave financiare, detyrimet kontingjente, trajtimi i borxheve të këqija, kreditë e marra, etj;
- Shpenzimet janë kalkuluar në mënyrë të duhura. Kosto e shërbimeve të shitura duhet të kalkulohet sipas kërkesave që dalin nga Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK 2 Stoqet); dhe
- Të rishikohet çështja e të arkëtueshmeve dhe provizioneve për borxhet e këqija në bashkëpunim me organet qendrore, përkatësisht aksionaret e saj. Lidhur me këtë, të nxirren politika të qarta dhe të respektohen kriteret nga Standardet e kontabilitetit se kur një borxh mund të shndërrohet në borxh të keq.

VII.3 Realizimi i Buxhetit

VII.3.1 Menaxhimi i të hyrave

Të hyrat e përgjithshme për vitin 2009 sipas raportimit financiar ishin 4,198,574€. Krahasuar me vitin 2008 është shënuar një rritje prej 584,106€ apo 16% .

Gjatë punës tonë audituese në këtë kategori kemi vërejtur se janë përfshi synimet kryesore në planin e biznesit, mirëpo nuk ekziston strategji formale afatshkurtër ose plan veprimi për të mundësuar realizimin e synimit strategjik.

Burimet kryesore të të hyrave janë siç vijojnë :

- Të hyrat nga faturimi në shumë prej 4,010,771€; dhe
- Të hyrat tjera 187,803€.

Sipas raportimit financiar, nga të hyrat e faturuara dhe shërbimet kontraktuese shkalla e inkasimit për vitin 2009 ishte 2,840,391€.

Gjatë procedurave të ndjekura gjatë auditimit, kemi identifikuar edhe këto mangësi:

Nuk janë bërë rregullime për lejimet e borxheve të dyshimta

Për përgatitjen e Pasqyrave Financiare, Standardet e Kontabilitetit kërkojnë që të merren parasysh rregullimet në kontabilitet të llogarive të arkëtueshme për të cilat vlerësohen shlyerjet dhe lejimet. Ne kemi vërejtur se kompania ka përdorur një sistem të kontabilitetit i cili nuk ofron mundësi për rregullimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta për përgatitjen e pasqyrave financiare sipas SKK.

Mos respektimi i marrëveshjes mbi grantet qeveritare

Marrëveshja në mes MEF-it dhe KRM “Pastrimi” kërkon që kompania të mbajë llogari bankare të veçantë për kategoritë e shpenzimeve kapitale. Ne kemi vërejtur se nuk ishte respektuar marrëveshja, sepse mjetet nga Granti Qeveritar nuk janë transferuar në llogarinë e veçantë bankare.

Të hyrat e shtyera nuk regjistrohen në periudhën e duhur

Të hyrat e shtyra në shumë prej 24,012€ nuk janë amortizuar gjatë vitit 2007 dhe 2008 sipas shpenzimit të tyre, mirëpo këto në tërësi janë amortizuar në vitin 2009.

Të hyrat e interesit nga depozitat nuk janë harmonizuar

Të hyrat nga interesi i depozitave në vitin 2009 të paraqitura në Pasqyra Financiare përfshijnë gabime të vogla në lidhje me harmonizimet.

Një e hyrë e fituar në vitin 2008 është bartur në vitin 2009

Është gjetur se në kategorinë e të hyrave të tjera në shumën e regjistruar prej 2,557€ është përfshirë shuma e fituar në vitin 2008 në vlerë prej 806€. Sipas parimit akrual, të hyrat që janë fituar në vitin vijues, në fund të çdo periudhe duhet të mbyllën.

Konkluzion

Ne konkludojmë se disa zëra në pasqyrat financiare (trajtimi i të arkëtueshmeve dhe provizionimi i borxheve të këqija dhe të dyshimta) nuk ishin trajtuar në pajtim të plotë me këto standarde dhe ligjet e aplikueshme. Amortizimi dhe harmonizimi duhet të kryhet në mënyrë më të saktë duke zvogëluar rezikun nga gabimet e vogëla në pasqyra financiare.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që:

- Të aprovohen politika të qarta në pajtim me SKK-të lidhur me evidencat kontabël;
- Të gjitha marrëveshjet që bëhen në emër të granteve të realizohen në bazë të dispozitave dhe kushteve të kontraktuara;
- Cilësia për sa i përket harmonizimeve të jetë sa më e mirë
- Të hyrat nga grantet të cilat shpenzohen gjatë vitit aktual të paraqiten si të hyra në pasqyrën e të ardhurave, ndërsa pjesa tjetër e pa shpenzuar të paraqitet si e hyrë e shtyrë në pasqyrën e bilancit të gjendjes; dhe
- Në dokumentet burimore të mbahen edhe fletëpagesat të cilat mund të prezantohen në raste të kontrollit.

VII. 3.2 Menaxhimi i Shpenzimeve

Kompania nuk ka sistem specifik të kontabilitetit të shpenzimeve. Menaxhmenti duhet të përdor klasifikimin e shpenzimeve sipas planit kontabël. Në mungesë të sistemit adekuat të kontabilitetit të shpenzimeve, menaxhmenti nuk mund të kryej një analizë të duhur të shpenzimit për secilën njësi organizative .

VII 3.2.1 Pagat dhe Personeli

Sipas të dhënave financiare, shpenzimet për paga bruto në vitin 2009 ishin 1,462,664€, ndërsa në vitin 2008 ishin 1,390,595€. apo 5% më të ulta se në këtë vit. Numri i punonjësve në vitin 2009 ishte 450 deri sa me plan biznesi është paraparë numri prej 436.

Sipas regjistrimit të ofruar nga zyra e personelit, gjatë vitit 2009, kompania ka punësuar gjithsej 21 punëtorë të rinj. Kompania na ka ofruar vetëm një listë të stafit të pranuar në punë, mirëpo nuk na ka ofruar dëshmi rreth rekrutimit të tyre.

Për shkak të mungesës të dokumentacioneve te nevojshme në dosje të personelit ne nuk mund të japim siguri të arsyeshme se procesi i rekrutimit është bërë në harmoni me rregulloret në fuqi.

Konkluzion

Kompania ka dështuar të rekrutoj stafin e saj në pajtim me rregullativen ligjore. Moszbatimi i kesaj rregullative, respektivisht Zyra e Personelit ka treguar funksionim jo adekuat të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që të siguroj:

Forcimin e kontrolleve se Zyra e personelit do të zbatoj të gjitha procedurat e rekrutimit në përputhshmëri me rregulloret në fuqi. Po ashtu, të sigurohet se ekzistojnë dosjet personale të të gjithë të punësuarve, duke përfshirë edhe performancën e tyre.

VII 3.2.2 Mallrat, shërbimet dhe investimet kapitale

Kemi kryer teste të pavarura për kategorinë e shpenzimeve të cilat kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit dhe shpenzimet tjera. Testet e kryera në fushën e prokurimit kanë identifikuar devijime nga Ligji i Prokurimit Publik Nr. 2003/17 i ndryshuar me Rregulloren Nr. 2007/20.

Të gjeturat

- Me kontratë për furnizim me naftë, e nënshkruar më 05 Maj 2008 me një operator ekonomik ishte paraparë që sasia e furnizuar të jetë 400,000 Litra, ndërsa ne kemi gjetur se kompania është furnizuar në sasi prej 434,700 Litra. Shuma e tejkalar dhe e paguar ishte 32,000€;
- Është nënshkruar kontrata me një operator ekonomik për kryerjen e shërbimeve në Podujevë duke anashkaluar procedurat e prokurimit për kontrata me vlerë të vogël mbi 1,000€;
- Dhënie e avansit prej 60% të vlerës së kontratës bazuar në pro-faturën e dërguar nga fituesi për furnizim me mjete transportuese. Kontrata ishte nënshkruar me datën 25 Gusht 2009 në shumë prej 327,120€; sigurimi e ekzekutimit nuk ishte bërë sipas kërkesave ligjore në vlerë prej 10%, mirëpo ishte bërë pas nënshkrimit të kontratës në vlerë prej 24,000€;
- Tek kontrata për furnizim me goma ishte shpërblyer ofertuesi me çmim më të lart, ndonëse është kërkuar që fituesi do të përzgjidhet sipas çmimit më të ulët. Diferenca në mes fituesit dhe të ofruesit me çmimin më të ulët ishte 2,430€;
- Tek furnizimi me thëngjill, kompania është furnizuar nga një operator, duke anashkaluar procedurat e prokurimit;
- Me 05 Janar 2009 është nënshkruar kontratë me një OE për kryerjen e shërbimeve për bartjen e mbeturinave, duke mos precizuar afatin kohor të përfundimit të shërbimeve kontraktuese;

- Komisioni për hapje dhe vlerësim të ofertave ishte caktuar në përbërje të njëjtë nga drejtori Menaxhues, si dhe për shërbimet e kryera është paguar OE i cili nuk figuron në listën e ofertuesve, Shuma e paguar ishte 1300€.
- Janë kryer pagesa në shuma mbi 100€ për furnizime me pjesë rezervë për automjete. Sipas pohimeve të menaxhmentit pagesat janë të lejuara deri në 500€ në të gatshme, për shkak të natyrës së biznesit. Ne nuk kemi gjetur ndonjë vendim apo udhëzim në formë të shkruar për këtë pohim të zyrtarëve të kompanisë.

Konkluzion

Kompania nuk ka arritur të siguroj një ambient të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm sa i perket realizimit të proceseve të prokurimit duke e rritur kështu rrezikun e mashtrimit, humbjes ose keqpërdorimit. Ne kemi gjetur parregullsi pothuajse tek të gjitha mostrat e testuara dhe jemi të shqetësuar me devijimet nga ligji i prokurimit.

Në përgjithësi, kontrollet e brendshme vlerësohen të dobëta për t'i ofruar siguri menaxhmentit se proceset e prokurimit dhe pagesave janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret.

Mungesa e vendimit që rregullon pagesat përmes arkës lejon që paraja e imët të mos kontrollohet. Për këtë arsye, ekziston rreziku që pagesat për një blerje të ndahen në disa fatura.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që:

- Të respektohen procedurat e prokurimit dhe të aplikohen më përpikëri kushtet e përcaktuara me kontratë;
- Të mos bëhen pagesa në avance në vlera të larta, pasi që ekziston rreziku që të mos kryhen punimet ose shërbimet në pajtim me kontratën;
- Të ndërpresë praktikata e blerjeve përmes arkës, për riparime dhe pjesëve rezervë;
- Me rastin e formimit të komisionit për hapje dhe për vlerësim të ofertave, të caktohen persona të ndryshëm, dhe të ketë një kontroll më të madh në ekzekutimin e pagesave;
- Të mos nënshkruhet kontrata pa e siguruar sigurimin e ekzekutimit të kontrates në pajtim me LPP-në; dhe
- Të forcohen kontrollet lidhur me punën e komisioneve të vlerësimit dhe zhvillimit të proceseve të prokurimit në përgjithësi dhe me kontrata të shpërblehen operatorët më të favorshëm.

VII 3.2.3 Subvencionet dhe Transferet

Prej kategorisë së subvencioneve kompania ka paguar për dhurata bamirëse në formë monetare dhe në ndihma në shumë prej 12,930€, ndërsa në emër të avanseve për punëtorët e saj ka paguar 84,868€.

Rishikimet tona lidhur me zbatimin e procedurave mbi subvencionet kanë rezultuar me mangësitë e paraqitura në vijim:

- Në bazë të vendimit të drejtorit menaxhues janë paguar nga 12,930€ në formë të pagesave për ditën e 8 Marsit, festës së Bajramit si dhe dhurata për festën e Vitit të Ri. Ne nuk kemi gjetur ndonjë rregullore të brendshme e cila rregullon këtë formë të ndihmave për punëtorët; dhe
- Dhënia e avanseve për punëtorët e brendshëm janë bërë në bazë të kërkesës së paraqitur të punëtorëve dhe me aprovim të drejtorit të financave. Ne nuk kemi gjetur se avanset e dhëna ndaj punëtorëve janë dhënë duke specifikuar kushtet si dhe afatin e kthimit të këtyre mjeteve në llogarinë e kompanisë.

Konkluzion

Mungesa e ndonjë rregullore, kornize ligjore apo udhëzimi të brendshëm për dhurata bamirëse për punëtorët e kompanisë, si dhe dhënia e avanseve për punëtorë të vet kompanisë, tregon kontrollin e dobët në menaxhimin e tyre.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që:

Të krijohet kornizë ligjore për shpenzimin e parasë publike për subvencione dhe transfere, dhe të forcohet kontrolli i brendshëm në shpenzimin e tyre.

VII.4 Menaxhimi i Prokurimit

Të gjeturat e raportuara në nën-kapitujt e mësipërm demonstrojnë se menaxhimi i procesit të prokurimit nuk ishte bërë në pajtim me LPP-në.

Kjo mund të përmblihdet nga shembujt e mëposhtëm:

- Nuk është bërë sigurimi i ekzekutimit në pajtim me rregullat dhe kërkesat e LPP-së;
- Dhënia e avansit 60% e vlerës së kontratës;
- Eliminimi i operatorit ekonomik me çmimin me të lirë;
- Furnizimet nga një operator ekonomik i cili nuk ishte zgjedhur në bazë të procedurave të prokurimit; dhe
- Pagesat nga paraja e imët për riparime.

Konkluzion

Ne konkludojmë se procedurat e prokurimit nuk janë zhvilluar plotësisht brenda kornizës ligjore të prokurimit si dhe kanë munguar kontrole të brendshme rreth procedurave kontraktuese. Shembujt e paraqitur me lartë tregojnë një menaxhim jo të mirë të këtyre procedurave duke rrezikuar mosarritjen e vlerës së parasë të shpenzuar.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që të sigurojë që:

- Të mos aprovoj asnjë pagesë në avans pa mbulesë me ndonjë garancion bankar;
- Të mos nënshkruaj asnjë kontratë me operatorët ekonomik pa sigurimin e ekzekutimit të tenderit;
- Të ndërpriten praktikat e tilla të furnizimit me thëngjill, dhe të aplikohen procedura të prokurimit për të lejuar një konkurrencë të lirë dhe transparente; dhe
- Të forcohen kontrollet lidhur me punën e komisioneve të vlerësimit dhe zhvillimit të proceseve të prokurimit në përgjithësi dhe me kontrata të shpërblehen operatorët më konkurrent dhe më të favorshëm.

VII.5 Menaxhimi i Pasurive

VII.5.1 Pasuritë aktuale

Në kuadër të kompanisë ekziston llogaria kryesore bankare NLB dhe BPB, ndërsa nën llogaritë tjera ishin llogaria bankare në BPB, BE, si dhe llogaria bankare në BKP. Qarkullimi vjetor në llogarinë e NLB-së ishte 3,080,427€, ndërsa gjendja në fund të vitit në këtë llogari ishte 208,235€.

Qarkullimi vjetor në llogarinë e BPB ishte 327,220€, ndërsa gjendja në fund ishte 2,024€, ndërsa në nën llogarinë tjetër në BPB ishin të deponuar mjete në shumë prej 110,555€ si mjete rezervë.

Me rastin e rishikimit të pagesave përmes parasë së imët, kemi gjetur se kompania gjatë vitit 2009 ka paguar pagesa të ndryshme në vlerë prej 167,998€. Sipas pohimeve të zyrtarit financiar, pagesa deri 500€ është kryer për shkak të natyrës së veprimtarisë, mirëpo ne nuk kemi vërejtur se ekziston ndonjë udhëzim për lejimin e pagesave deri në limitin e cekur.

Konkluzion

Mungesa e ndonjë rregullore apo udhëzimi të brendshëm e cila do të rregullonte çështjen e pagesave përmes parasë së imët krijon hapësirë për ndarjen e faturave dhe mundësi për pagesa të pakontrolluara.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që:

Të vendosë politika dhe procedura të shkruara që rregullojnë përdorimin e parasë së gatshme, të cilat do të rregullonin menyrën e përdorimit të parasë së gatshme, limitet në transaksionet e caktuara me para të gatshme dhe dokumentacionin e nevojshëm për të proceduar pagesat.

VII.5.2 Pasuritë Fikse

Kompania nuk ka shpalosur metodën e llogaritjes së amortizimit për pasurinë fikse. Po ashtu, regjistri i inventarit është mbajtur vetëm në sasi, ndërsa mungonin vlerat e tyre, data e blerjes dhe prejardhja e tyre.

Gjatë ekzaminimit fizik të inventarit kemi gjetur se asnjë artikull nuk është i pajisur me barkode.

Konkluzion

Mangësitë e vërejtura lidhur me pasuritë themelore tregojnë që kompania ende nuk ka siguruar kontroll të mjaftueshëm në menaxhimin e tyre. Mungesa e shpalosjeve të metodës së zhvlerësimit, mungesa e vënies së barkodeve si dhe mungesa e shënimeve të plota në regjistrat kontabël janë problemet kyçe në menaxhimin e tyre. Kjo mund të rrit rrezikun e humbjes apo keqpërdorimit të tyre

Rekomandimi 8

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që:

- Të mbahen shënime shpjeguese për metodat e zhvlerësimit të pasurive fikse;
- Të mbajë evidencë për pasuritë e saj dhe të vendos barkode në to në menyrë që të këtë kontroll të plotë në menaxhimin e tyre; dhe
- Të bëjë inventarizimin e rregullt fizik për të siguruar ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit fizik me të dhënat kontabël dhe regjistrin të pasurive..

VII.6 Menaxhimi i detyrimeve kontingjente

Fatura në vlerë prej 12,992€ nuk ishte prezantuar si detyrim kontingjent në pasyrat financiare të kompanisë për vitin 2008. Kjo është vërejtur gjatë testimin të pagesave të detyrimeve kontingjente në vitin 2009. Kjo pagesë ishte bërë më një vendim gjyqësor për një punëtor të kompanisë të suspenduar në vitin 2001.

Konkluzion

Shpenzimet në bazë të vendimit gjyqësor kompania nuk i ka regjistruar në mënyrë të drejtë. Këto shpenzime i ka postuar si shpenzime të terminalit. Mungesa e politikave të përshtatshme mbi detyrimet, redukton aftësinë e menaxhmentit për kontroll dhe marrjen e vendimeve të drejta dhe efektive sa i përket kësaj. Për më tepër detyrimet kontingjente, kompaninë mund ta sjellin në vështirësi të pa pritura financiare.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që të siguroj se:

- Kontabilitetit disponon me të gjitha informatat për detyrimet e papaguara dhe këto detyrime janë të prezantuara drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare; dhe
- Detyrimet e papaguara duhet të shpalosen, të vlerësohen dhe të buxhetohen për vitin vijues.

VII.7 Menaxhimi i TVSH-së

Ne kemi qenë të informuar nga kryesuesi i departamentit të financave deklaratat e TVSH-së janë duke u bërë sipas pagesave e jo sipas faturimeve, që nuk është në pajtueshmëri me Rregulloren e TVSH-së. Deklarimet në këtë formë kompania i arsyeton me vështirësinë e mbledhjes së borxheve nga klientët.

Menaxheri i financave ka shpjeguar se është në konsultim me Autoritetet e Tatimeve në Kosovë për këtë mënyrë të llogaritjes dhe përgatitjes së deklaratave të TVSH-së. Megjithatë kompania nuk ka ndonjë konfirmim të shkruar lidhur me këtë çështje.

Konkluzion

Autoritet tatimore mund të rivlerësojnë deklaratat mujore të TVSH-së të përgatitur nga Kompania. Po ashtu mund ta ngarkojnë me gjoba dhe interes përkatës për mos deklarim dhe pagesë në pajtim me kërkesat e Ligjit të TVSH-së.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që:

Të kërkojnë ndonjë dokument me shkrim nga ATK lidhur me çështjen e përgatitjes dhe dorëzimit të deklaratave të TVSH-së bazuar në pagesën e faturave, në mënyrë të largimit të ndonjë rreziku të mundshëm.

VII. 8 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizate në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, duke siguruar raportim të besueshëm financiar.

Ne kemi identifikuar menaxhim dhe kontroll jo të mirë në fushat në vijim, siç është shfaqur në seksionet më lart.

- Pagesat e shumta përmes arkës në mungesë të ndonjë rregullore të brendshme;
- Avanset e dhëna ndaj punëtorëve pa pasur mbështetje juridike;
- Mungesa e një mekanizmi për inkasimin e borxheve të vjetra, dhe
- Sisteme joadekuate për regjistrimin dhe monitorimin e pasurive fikse, duke përfshirë në këtë kontekst edhe mungesën e shenjave identifikuese për pajisjet.

Konkluzion

Kapitujt e përshkruar më lartë flasin për dobësi evidente të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe implementimit të tyre. Dështimi për të themeluar Bordin e drejtorëve si dhe njësisë për auditim të brendshëm paraqesin probleme kyçe për funksionimin në tërësi të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Ne konsiderojmë se niveli i kontrollit financiar mund të përmirësohet nëse do të ekzistonte Bordi i drejtorëve dhe njësia për auditim të brendshëm.

Rekomandimi 11

Rekomandojmë aksionaret e kompanisë që të siguroj:

Që të themelojnë Bordin e Drejtoreve, i cili pastaj do të krijojë një ambient të pershtatshëm të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit financiar të organizatës.

VII. 9 Auditimi i Brendshëm

Ligji për ndërmarrjet publike parasheh që në kuadër të një ndërmarrje publike të formohet njësia për auditim të brendshëm i cili do të kryente funksionin e saj të pavarur dhe do të ushtronte detyrat me kompetencë.

Në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" ende nuk është themeluar njësia për auditim të brendshëm.

Konkluzion

Nga mungesë të themelimit të njësisë së auditimit të brendshëm ne konkludojmë se kompania nuk ka arritur të krijojë një ambient të mirë të kontrollit. Themelimi i kësaj njesie do të forconte ambientin e kontrollit të brendshëm duke sugjeruar përmirësime të nevojshme të sistemit.

Rekomandimi 12

Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që:

Të themeloj komisionin për auditim të brendshëm dhe njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat do luanin një rol të rëndësishëm në krijimin e një ambienti adekuat të kontrolleve të brendshme.

VII.10 Konkluzioni i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi” Prishtinë

Bordi i Drejtoreve ende nuk është emëruar. Mungesa e themelimit të tij ka ndikuar në moskrijimin e parakushteve të nevojshme për një menaxhim efektiv të duhur të përcjellë me kontrolle të brendshme adekuate.

Problemet kyçe janë lidhur më inkasimin e të hyrave. Inkasimi nuk është në nivelin e kënaqshëm. Të hyrat e pa inkasuara ishin provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta që si pasojë e kësaj pasqyrat financiare të kompanisë gjatë kësaj periudhe kishin rezultuar me humbje.

Kjo dhe dobësitë e tjera të identifikuara në këtë raport lidhur me shpalosjet e pasqyrave financiare, regjistrimet e shpenzimeve në kodet e duhura, regjistrimi i pasurisë sipas barkodeve si dhe sistemin e kontrollit të brendshëm na kanë shtyre deri të një konkluzion i përgjithshëm se nevojitet përpjekje e mëtejshme nga menaxhmenti për të siguruar një menaxhim me të mirë dhe me kualitativ.

Në këtë kuptim ne rekomandojmë aksionaret e kompanisë që të themelojnë Bordin e Drejtoreve, i cili pastaj duhet të krijojë një ambient të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit financiar të organizatës.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);

(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

(d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksim i çështjes.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

(a) ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit

Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

(b) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit të pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jep një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca 2

Menaxhmentit të KRM “Pastrimi” Prishtinë i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditor dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si me poshtë:

Komentet e KRM “Pastrimi”Sh.a – Prishtinë dhe konkluzionet e ZAP-it

Nr.	Referenca		Konkluzionet finale te ZAP
1.	VII 3.2.1 Pagat dhe Personeli	<p>Rekrutimi i fuqisë punëtore (personelit) gjatë vitit 2009, është bërë në përputhje me nevojat e domosdoshme dhe minimale që ka kërkuar procesi i punës, me qëllim të përballimit të nevojave operative në kryerjen e shërbimeve publike.</p> <p>Punësimi i punëtorëve është bërë në pajtim me dispozitat e Ligjit aktual të punës, përkatësisht nenit 10 të Ligjit Themelor të Punës së Kosovës dhe nenit 7 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive.</p> <p>Kërkesat për fuqi të re punëtore janë paraqitur në Entin Rajonal të Punësimit dhe pastaj nga numri i rekomanduar nga Enti i Punësimit është përzgjedhur numri i nevojshëm.</p> <p>Ne sigurojmë se për çdo të punësuar ekziston dosje e veçantë personale me dokumentacionin bazë dhe shënimet e domosdoshme.</p> <p>Menaxhmenti zotohet se rekomandimit të Auditorit nga kjo sferë do t’i kushtohet vëmendje për të forcuar respektimin e procedurave dhe rregullave të zbatueshme.</p>	<p>Sipas planit të biznesit të cilin ju e keni përgatitur është paraparë që numri i punëtorëve në kompaninë tuaj për vitin 2009 do të jetë 436 punëtorë, ndërsa numri i përgjithshëm në fund të vitit të audituar ishte 450 punëtorë. Në plan të biznesit nuk është paraparë një rritje të numrit të të punësuarve në kuadër të kompanisë. Përveç tjerash në kohën e auditimit nuk kemi gjetur se ekzistojnë ndonjë konkurs me kushtet dhe kriteret të cilat do duhej ti pranojë një i punësuar.</p> <p>Përpjekjet e kompanisë dhe zotimet e dhëna në fund të këtij komenti ne do ti mirëpresim.</p>

2.	VII 3.2.2 Mallrat, Shërbimet dhe Investimet Kapitale	Në bazë të marrëveshjes së kontratës nr. 08/009/121 lënda e kontratës është furnizimi në litra 448000 litra, kështu që në baze të rekomandimit tuaj nuk kemi sasi të tejkaluar.	Në kuadër të kontratës për furnizim me naftë është paraparë që sasia e cila do të liferohet për kompaninë ishte 448000 litra. Ne për testim kemi marrur sasinë prej 400 000 litra e cila është paraparë furnizim vetëm për qendrën e kompanisë në Prishtinë jo për njësitë e saja. Në bazë të testeve kemi vërejtur se sasia e pranuar në vitin 2009 ishte më I larte në krahasim me sasinë e kontraktuar.
3.	VII.5.1 Pasuritë aktuale	Sqarojmë se nga specifikat e procesit të punës, të cilat imponojnë veprime urgjente në kryerjen e Shërbimeve Publike, në raste të caktuara, kemi qenë të detyruar të lejojmë pagesa të gatshme deri në 500€. Ne do të vendosim politika dhe procedura për rregullimin e fondit të parasë së gatshme.	Menaxhmenti i kompanisë pajtohet me dobësitë ekzistuese dhe nuk e konteston të gjeturën, por vetëm jep arsyetimin. Në auditimin e radhës do të përcjellim shkallën e implementimit. Gjetjet e auditimit mbeten të pa ndryshuar.
4.	VII.5.2 Pasuritë fikse	Pjesërisht pranohet rekomandimi pasi gjitha pajisjet (mjetet themelore) posedojnë numrin e prodhuesit, ndërsa inventarin do ta kodojmë gjatë regjistrimit të rregullt vjetor.	Rekomandimi i ZAP-it për këtë ishte që të gjitha asetet dhe inventari duhet të jenë të identifikuar me një numër (Barcode) të asetit i cili interferon me regjistrin e aseteve fikse. Konkluzionet e auditimit mbesin.
5.	VII.7 Menaxhimi I TVSH-se	Do të jemi koshient për zbatimin e plotë të PVF-ve, sipas parimeve të kontabilitetit për Shoqëritë Aksionare. Konfirmim zyrtar në lidhje me deklaratat e TVSH-se -Memorandumi i Mirëkuptimit për Tatimin në vlerën e shtuar (TVSH).	Ne inkurajojmë menaxhmentin e Kompanisë për veprimet që do të ndërmerren dhe në auditimin e radhës do të shohim nga afër progresin e arritur. Konkluzionet e auditimit mbesin.

Më tutje, Menaxhmenti është zotuar që do të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.